

STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"KLAKEV" s.h.p.k "

Sot, me date 10.12.2019 , ne Tirane, Shqiperi, personat e meposhtem:

- 1) **Z. Kevin Ahmetaj** ,me atesi Nairn shtetas shqiptar, lindur me 20.10.1993 ne Tirane dhe banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit nr.**J31020081R** , madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar,vendos te themeloje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me legjislacionin e Republikes se Shqiperise dhe me dispozitat ne vijim:

Neni 1

Themelimi

- 1.1 Emri i shoqerise eshte " **KLAKEV**",**h.p.k**", ketu me poshte e quajtur "**Shoqeria**". Shoqeria eshte themeluar ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
- 1.2 Shoqeria fiton personalitet juridik me regjistrimin ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.
- 1.3 Shoqeria do t'ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin.

Neni 2

Selia

- 2.1 Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: ne RrUGen " Egnatia" Pallati IB Contruction. Shkalla 1. , ap nr 26 .Laprake Tirane .
- 2.2 Shoqeria mund te hap dege dhe zyra perfaqesimi ne qytete te tjera te Republikes se Shqiperise dhe/ose jashte saj.

Neni 3

Objekti

- 3.1 Objekti i Shoqerise do te jete:

Transport, Ndertim, Inerte, Germim. Veprimtari ne fushen e ndertimit, prodhim, montim te cdo lloj qofshin civile, industriale apo bujqeosre, ndertim linja elektrike, hidraulike, ujesjellesa, kanalizime, rruge, prita, ura, tunele, vepra arti e restaurime. Ne fushen e studimii, projektimit, ndertimit e shfrytezimitte objekteve civile, industriale, bujqesore, HeC-ve, gurore, gjithë llojeve te materialve te ndertimit si inerte, betoni, parafabrikate te ndryshme dhe konstruksion e tubacione metalike te te gjitha llojeve etj. Kryerja e cdo lloj operacioni dhe transaksioni ne lidhje me importimin, eksportimin, prodhimin dhe tregtimin me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshme



ushqimore, industriale, bijqesore e blegtorale. Veprimtarin e shkembimeve valutore, transfertave dhe postave brenda dhe jashte vendit. Transport mallrash e udhetaresh me mjete rrugore, detare dhe ajrore brenda dhe jashte vendit. Infrastruktura, ujesjellesa, kanalizime, vepra pastrimi te ujit te pijshem, vepra pastrimi te ujrave te zeza. Ndertim hidrocentralesh, ndertim dhe instalime fotovolmetrike. Ndertim i veprave te restaurimit dhe i rikonstruksionit te tyre. Ndertime ne det. Punime te mbrojtjes lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime. Punime kundra zhurmes ne infrastrukture. Punime kundra zhurmes per ndertime social kulturore. Punime gjeologjikeinxhinierike. Punime te perpunimit dhe trajtimit te mbetjeve urbane. Punime te strukturave speciale. Punime per prishjen e ndertimeve. Punime te inxhinierise se mjedisit. Ndertime per nenstacionet, kabinave e transformatoreve, linjat e nenstacionit te mesem per energjine. Etj.

Neni 4

Kohëzgjatja

- 4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

Neni 5

Kapitali Themeltar dhe Ortakët

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 **Leke** (njeqind mije)
- 5.2 Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga Ortaku i vetem ,100% ne 1 kuote , **Z. Kevin Ahmetaj** ,me atesi Naim shtetas shqiptar, lindur më 20.10.1993 ne Tirane dhe mbanues në Tirane, mbajtës i letërnjoftimit nr.**J31020081R** , madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar
- 5.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë.
- 5.4 Përgjegjësia e Ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 6

Asambleja e Përgjithshme

- 6.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e këtij Statuti, janë të detyrueshme për të gjithë Ortakët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime.



Neni 7
Administratori

- 7.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administrator/ë, i/të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.
- 7.2 Administratori i parë i Shoqërisë është: **Z.Kevin Ahmetaj**, me atesi Naim shtetas shqiptar, lindur më 20.10.1993 ne Tirane dhe mbanues në Tirane, mbajtës i letërnjoftimit nr.**J31020081R**, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar
- 7.3 Mandati i Administratorit është për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, i rinovueshëm, dhe, nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.
- 7.4 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori i cili është përgjegjës personalisht për shkelje të ligjit dhe të Satutit dhe për gabimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

Neni 8
Viti Financiar

- 8.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.
- 8.2 Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2015.

Neni 9
Të ndryshme

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar dhe nënshkruar në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe, dhe italiane me të njëjtën vlerë secila.

ORTAKU

Kevin Ahmetaj
